

UDHËZIM
Nr.11, datë 29.9.2003

**PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË LISTËS SË ZGJEDHËSVE QË PËRDOR KQV
DITËN E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe 6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

1. Pas evidentimit të numrit të zgjedhësve që kanë votuar, sipas nënshkrimeve në listën e zgjedhësve, kjo listë futet në zarf, zarfi nënshkruhet nga kryetari e zëvendëskryetari i KQV-së dhe vulozet nga kryetari i saj.
2. Në fund të procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve në QV, zarfi ku është vendosur lista e zgjedhësve futet në kutinë e votimit.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë